



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:714/25 Datë:20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohet programi i studimeve të Kolegjit UBT, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):

1. *Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës, MSc (120 ECTS) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.*

II. Akreditohen programet e studimeve të Kolegjit UBT, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):

2. *Dizajn, BP (180 ECTS) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
3. *Dizajn i Modës, BP (180 ECTS) me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik.*
4. *Shkenca Politike, MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
5. *Studime të Sigurisë, MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*

III. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

IV. Obligohet Kolegji UBT që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

V. Obligohet Kolegji UBT të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.

VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 3

ARSYETIM

Kolegji UBT brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës, MSc (120 ECTS) (R)</i>	Hysen Ahmeti Visar Krelani Skender Bublaku Hazir Cadraku
2.	<i>Dizajn, BP (180 ECTS) A</i>	Milot Gusija Arbresha Hoxha Dardan Luta
3.	<i>Dizajn i Modës, BP (180 ECTS) A</i>	Hana Zeqa Cennet Lika Nertila Memaj Aferdita Statovci
4.	<i>Shkenca Politike, MA (120 ECTS) A</i>	Ridvan Peshkopia Hajdi Xhixha Avni Alidemaj
5.	<i>Studime të Sigurisë, MA (120 ECTS) A</i>	Muazam Halili Alban Maliqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës, MSc (120 ECTS)*, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Philippe Bouillard, Tihomir Dokšanović dhe Arnoldas Solovjovas është organizuar më 19.02.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:**
 - Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Dizajn, BP (180 ECTS)*, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje : Ana Vivoda, Peter Purg dhe Nino Alavidze është organizuar më 16.04.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:**
 - Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Faqe 2 nga 3

3. **Për programin e studimit; Dizajn i Modës, BP (180 ECTS)**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje : Ana Vivoda, Peter Purg dhe Nino Alavidze është organizuar më 16.04.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
- Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Shkenca Politike, MA (120 ECTS)** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Matthew Kitching, Kristijan Kotarski dhe Stefan-Marius Deaconu është organizuar më 12.05.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.
5. **Për programin e studimit; Studime të Sigurisë, MA (120 ECTS)** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Matthew Kitching, Kristijan Kotarski dhe Stefan-Marius Deaconu është organizuar më 12.05.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
- Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 138-të, të mbajtur më datë 16.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT ;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

